

# PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Broshurë 3-mujori i katërt  
Tetor - Dhjetor 2025



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



SHOQËRIA



EDUKIM  
FINANCIAR



MJEDISI



EKONOMIA



EKONOMIA

SHOQËRIA

EDUKIMI  
FINANCIAR

MJEDISI

**Përgjegjësia Sociale e Korporatave (CSR)** është konsoliduar si një shtyllë strategjike e veprimtarisë së bankave në Shqipëri, duke reflektuar një angazhim që shkon përtej rolit tradicional financiar. Ky orientim dëshmon vizionin e sektorit bankar për të kontribuar në mënyrë aktive në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më të qëndrueshme dhe më gjithëpërfshirëse.

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2025, institucionet bankare kanë zbatuar një sërë nismash me ndikim konkret në mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e kushteve socio-ekonomike dhe forcimin e përkujdesjes sociale, duke treguar se qëndrueshmëria është tashmë pjesë integrale e strategjive të tyre afatgjata.

Përmes mbështetjes për arsimin, projekteve sociale dhe iniciativave mjedisore, bankat vijojnë të ndërtojnë partneritete të forta me komunitetet dhe të kontribuojnë në krijimin e vlerës së përbashkët për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare.





## DIMENSIONI I MJEDISIT

### BANKA CREDINS

- iu bashkua nismës së Bashkisë Kamëz për gjelbërimin e Parkut të Paskuqanit, duke dhuruar 22 fidanë pemësh dhe ofruar komunitetit mundësinë për të shijuar një hapësirë më të gjelbër.

### BANKA INTESA SANPAOLO SHQIPËRI

- mori pjesë në panairin për sektorin privat, në kuadër të fushatës për ekonominë qarkulluese dhe financimet e gjelbra, duke prezantuar produktet financiare të gjelbra dhe angazhimin ndaj parimeve ESG.

### BANKA OTP SHQIPËRI

- mbështeti aktivitetin e mbjelljes së 100 fidanëve pemësh vendase përgjatë brigjeve të Lumit Vjosë në Memaliaj, në bashkëpunim me Shoqatën "Lumi" dhe vullnetarët Green Hearts, duke kontribuar në ruajtjen e zonave të rrezikuara dhe promovimin e trashëgimisë mjedisore.
- organizoi një aktivitet për eksplorimin dhe promovimin e Liqeneve Akullnajore të Lukovës në Pogradec, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, guidën "Discover Pogradec" dhe Bashkinë Pogradec, dhe konkludoi me vendosjen e një photo-frame për turistët si simbol të përkujdesjes ndaj natyrës.



6 UJË I PASTËR DHE KANALIZIME



13 VEPRIM PËR KLIMËN



14 JETA NËN UJË



15 JETA NË STERË





### BANKA PROCREDIT SHQIPËRI


- mori pjesë në “Green Building Council Albania (GBCA) Launching Event” në Tiranë, duke kontribuar në panelin e diskutimit dhe ndarë përvojën dhe angazhimin për promovimin e një sektori ndërtimi më të gjelbër dhe më efikas.
- nisi një fushatë për financimin e automjeteve elektrike, duke ofruar deri në 100% mbulim për klientët individë dhe bizneset, me qëllim mbështetjen e kalimit drejt transportit të qëndrueshëm.
- mori pjesë në Samitin dhe Ekspozitën Ndërkombëtare të 7-të “Balkan Power – Hydro, Solar, Wind: Where Investments Meet Technologies”, të organizuar nga Voctock Capital, duke ndarë përvojën dhe angazhimin e bankës në financimin e investimeve të gjelbra.



### BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE (ABI), BANKA KOMBËTARE TREGTARE (BKT) DHE BANKA CREDINS:

kontribuan në edicionin e 7-të të “Rrathë Dhurues” përmes projektit “MALGA” (Mal, Gur, Ajër), të organizuar nga Partners Albania, për rigjenerimin e bukurive natyrore të Parkut Kombëtar “Lurë-Mali i Dejës” dhe promovimin e mbrojtjes së mjedisit.

Përveç këtij projekti, **BKT** mbështeti “Bankina që Tregon” nga Fondacioni “Së Bashku”, dhe “Inovatorët e Rinj të së Ardhmes” nga Fondacioni Komunitar “Korçarët ndihmojmë Korçarët”, duke nxitur ndërgjegjësimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe zhvillimin e ideve inovatore të të rinjve.



6 UJË I PASTËR DHE KANALIZIME



13 VEPRIM PËR KLIMËN



14 JETA NËN UJË



15 JETA NË STERE





## **BANKA KOMBËTARE TREGTARE (BKT)**

- mbështeti Konferencën Ndërkombëtare për Ekonominë, Biznesin, Inovacionin dhe Teknologjinë, të organizuar nga Universiteti i Tiranës, duke kontribuar në promovimin e inovacionit, zgjidhjeve digjitale dhe rolit të inteligjencës artificiale në zhvillimin ekonomik.

## **BANKA CREDINS**

- mbështeti Connect Albania Forum '25, një event i fokusuar në vizionin ekonomik "Cashless 2030", në partneritet me Mastercard.
- u angazhua në Panairin e Punës të organizuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, duke i ofruar studentëve mundësi për t'u njohur me sektorin bankar dhe për të zhvilluar karrierën përmes punësimit dhe praktikave mësimore.
- kontribuoi për të tretin vit radhazi në eventin "Financa e Gjellbër, investim në sipërmarrje të qëndrueshme" në kuadër të Javës Globale të Sipërmarrjes '25, duke ofruar produkte dhe shërbime inovative që mbështesin zhvillimin e ekonomisë vendase.
- sponsorizoi eventin "Një e Ardhme e Qëndrueshme Made in Albania" të organizuar nga UNDP Albania, duke bashkuar përfaqësues të qeverisë, biznesit, investitorëve dhe akademisë për të diskutuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të ardhmen e ekonomisë shqiptare drejt Bashkimit Evropian.






## **BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHQIPËRI (FIBANK)**

- hapi dy degë të reja në Kamëz dhe Kavajë, duke zgjeruar aksesin ndaj shërbimeve financiare për komunitetet dhe bizneset lokale.
- organizoi dhe mori pjesë në “Open Banking Workshop”, duke promovuar rolin e open banking në transparencë, konkurrencë dhe zgjidhje financiare për klientët.

## **BANKA INTESA SANPAOLO SHQIPËRI**

- mori pjesë në “Start-Up Award 2025” të organizuar nga Qendra e Inovacionit e Intesa Sanpaolo në Torino, duke mbështetur inovatorët e rinj shqiptarë dhe zhvillimin e sipërmarrjeve përmes platformës AIFO.





## **BANKA PROCREDIT SHQIPËRI**

- mori pjesë si partner në panairin “Future2Tech”, duke prezantuar zgjidhjet digjitale të bankës në panelin “Shqipëria në Epokën SEPA & Open Banking” dhe praktikat e qëndrueshme në panelin “Innovate like AIE”.
- nënshkroi marrëveshje në kuadër të programit Western Balkans Green Outcomes-Linked Debt (WB GOLD) me EBRD, me vlerë deri në 10 milionë euro, për të nxitur bizneset shqiptare drejt tranzicionit të gjelbër, uljes së ndotjes dhe rritjes së efikasitetit energjetik.
- mori pjesë në EXPO 2025 të organizuar nga UN Women, në panelin “Digitalization & Finance in Enterprises”, për të diskutuar rolin e teknologjisë dhe financave digjitale në fuqizimin e grave sipërmarrëse.
- lançoi dy paketa të reja financimi prej 4 milionë € për SME-të shqiptare, me mbështetjen e EBRD dhe BE: 3 milionë € për “Go Digital”, për projekte që rrisin digjitalizimin, automatizimin dhe investimet e gjelbra, dhe 1 milion € për “Women in Business”, për ndërmarrjet e drejtuara nga gratë, duke ofruar financim dhe asistencë teknike.
- mori pjesë në Global Entrepreneurship Week – Albania 2025, ku prezantoi platformën ProConnect për zgjerimin e biznesit dhe informoi pjesëmarrësit mbi mundësitë e programit GEF të BERZH për investime në produkte efçiente.



7 ENERGJI E PËRBALLUESHME



8 PUNË DIBLITOCZE DHE BRETJE EKONOMIKE



9 INDUSTRI INOVAÇION DHE INFRASTRUKTURË



11 QYTETE DHE KOMUNITETE ET GJERESHME



12 KONSUMI DHE PRODHIMI I PËRQJESHËM






## UNION BANK

- sponsorizoi “The Leadership Forum”, në partneritet me JM Solution, ku u diskutua mbi “Rritemi së bashku: Udhëtimi i Shqipërisë drejt një Europe të Rinovuar” dhe mënyrat për të përgatitur bizneset SME shqiptare të jenë konkurruese në tregun e BE-së.
- vijoi promovimin e kartës “Studenti 2 në 1” në universitetet publike dhe private të Tiranës, duke kombinuar avantazhet e kartës së debitit me çmimet preferenciale dhe shërbimet e partnerëve të Bashkisë Tiranë, për një përvojë unike për studentët.

Që nga 7 tetori 2025, **të gjitha bankat tregtare në Shqipëri kanë nisur transfertat SEPA në euro**, duke ofruar pagesa ndërkufitare më të shpejta, më efikase dhe me kosto më të ulët për individë dhe biznese. Ky standard i ri integron tregun financiar shqiptar me infrastrukturën evropiane.



**S€PA**  
Single Euro Payments Area



7 ENERGJI E PËRBALLUESHME



8 PUNË DINJTOZE DHE  
BRETJE EKONOMIKE



9 INDUSTRI, INOVACION  
DHE INFRASTRUKTURË



11 QYTETE DHE KOMUNITETE  
TE GJESHME



12 KONSUMI DHE  
PRODHEMI I PËRQJESHËM





## BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE (ABI)

- mbështeti edicionin e dytë të konkursit “Transport, Inovacion dhe Siguri 2025” të DPSHTRR-së, duke inkurajuar studentët të kontribuojnë me ide dhe teknologji inovative për përmirësimin e sektorit të transportit rrugor.
- mbështeti prezantimin e “Identitetit Digjital – Identitek” në Innovation Hub, duke kontribuar në promovimin e inovacionit dhe transformimit digjital në shërbim të qytetarëve.
- si partner i platformës Smile, mbështeti dhurimin e 10 inkubatorëve për foshnjat prematurë, në disa nga qytetet kryesore të Shqipërisë.
- mbështeti Klubin e Volejbollit Skënderbeu, duke promovuar edukimin, zhvillimin e të rinjve dhe vlerat sociale për brezat e ardhshëm.
- si sponsor zyrtar i Teatrit Kombëtar, mbështeti artin, kulturën dhe artistët shqiptarë, duke kontribuar në zhvillimin e vlerave kulturore dhe komunitare.


## BANKA KOMBËTARE TREGTARE (BKT)

- mbështeti debutimin e Orkestrës Simfonike të TKOB-së në Festivalin “Respighi Bologna 2025” në Bolonjë, duke promovuar muzikën shqiptare në skenën evropiane.
- promovoi vlerat kombëtare duke mbështetur aktivitetet festive të organizuara në kuadër të 100-vjetorit të krijimit të Forcës Detare.
- mori pjesë në projektin “Kutia e Dashurisë”, duke përgatitur dhe shpërndarë paketa ushqimore për familje në nevojë dhe komunitete lokale, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe qendrat komunitare.



## BANKA CREDINS

- gjatë muajit tetor, zhvilloi aktivitete të ndryshme për ndërgjegjësimin për një jetë të shëndetshme, duke përfshirë sporte, trajnime mbi mirëqenien, prindërimin pozitiv dhe fizioterapinë, për të forcur dhe socializuar jetën e punonjësve.
- mbështeti konkursin “NASA Space Apps Challenge” në Shqipëri, ku 50 të rinj shpalosën kreativitetin dhe aftësitë e tyre për të krijuar zgjidhje inovative me të dhënat publike të NASA-s.
- mbështeti eventin kulturor “Kënga ime ndaj nat’ herë”, dedikuar sopranos Tefta Tashko Koço, duke nderuar figurat artistike që kanë shënuar artin shqiptar.
- mbështeti eventin “Topi i Artë 2025”, duke vlerësuar pasionin, talentin dhe sakrificën e sportistëve më të mirë në futboll.
- iu bashkua për të pestin vit radhazi fushatës ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave, të organizuar nga UNDP, duke sensibilizuar përmes kanaleve të bankës dhe dhuruar pako ndihmash për 50 gra dhe vajza të dhunuara në qendrën “VATRA” në Vlorë.
- mbështeti 27 institucione publike, organizata dhe OJF në fushat e arsimit, mjedisit, punësimin, teknologjisë dhe shëndetësisë, përmes dhurimeve që kontribuojnë në përmirësimin e komunitetit.
- mbështeti 8 projekte për komunitetin përmes platformës SMILE, duke ofruar ndihmë në arsim, programe për individë me aftësi të kufizuara, përkujdesje për të moshuarit, si dhe kurse, trajnime dhe programe punësimi për gratë dhe vajzat e dhunuara, në bashkëpunim me institucione private, OJF dhe OJQ.
- organizoi aktivitete sensibilizuese gjatë festave të fundvitit për shtresat në nevojë, duke sjellë gëzim për 50 fëmijë jetimë dhe me të ardhura të pakta dhe për 70 të moshuar në shtëpinë “Sefer Dervishi” në Kavajë, me drekë speciale dhe dhurata të financuara nga punonjësit e bankës.



1 PA VARFËRI



2 ZERO URI



3 SHËNDETTI I MË DHE MIRËQENË



4 ARSIM GJËLSOR



5 BARAZI GJINËRE



10 ZIVOGËSI I PABARAZYVE



16 PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA



17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT





## **BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHQIPËRI (FIBANK)**

- mori pjesë në Health Fair / Conference, ku prezantoi zyrtarisht Kreditë për Shëndetin, një produkt financiar që mbështet individët në qasje ndaj shërbimeve thelbësore mjekësore, dentare dhe estetike.
- vazhdoi mbështetjen për Lara Colturi dhe Federatën Shqiptare të Skive gjatë sezonit dimëror 2025 - 2026, duke promovuar pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare, sportin e të rinjve dhe zhvillimin e sporteve dimërore në zonat malore.

## **BANKA INTESA SANPAOLO SHQIPËRI**

- organizoi konkursin edukativ "Money Master Challenge" për nxënës 12–13 vjeç, në bashkëpunim me Grupin Intesa Sanpaolo, Muzeun e Kursimeve në Torino, Ministrinë e Arsimit dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, ku shkolla fituese "Servete Maçi" përfaqësoi Shqipërinë në fazën ndërkombëtare.
- mbështeti fushatën "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore", në bashkëpunim me UN Women, për të rritur ndërgjegjësimin mbi dhunën digjitale ndaj grave dhe vajzave.
- mbështeti fushatën ndërgjegjësuese "Për çdo fëmijë, një familje!" në Ditën Botërore të Fëmijëve, duke përdorur ekranet e ATM-ve për të promovuar kujdesin prindëror dhe mbështetjen familjare, në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri.
- vazhdoi bashkëpunimin me College of Europe in Tirana, duke mbështetur me bursa tri studentë pasuniversitarë në vitin akademik 2025 - 2026 me një kontribut total prej 27,000 €.
- mbështeti aktivitetin "Settimana della Cucina Italiana nel Mondo" në Vlorë, të organizuar nga Konsullata e Përgjithshme e Italisë, duke promovuar kulturën italiane dhe forcuar dialogun dhe bashkëpunimin mes komunitetit dhe partnerëve të biznesit.
- mbështeti fushatën e kartolinave të Fondacionit Down Syndrome Albania 2025, duke kontribuar me fonde për shërbimet terapeutike të fëmijëve në qendrën "PRO PAK".





## **BANKA OTP SHQIPËRI**

- mbledhi dhe dhuroi 3,150 kg ushqime për familjet në nevojë, në partneritet me Food Bank Albania, duke aktivizuar stafin e degëve dhe Zyrat Qendrore për të demonstruar solidaritet ndaj shtresave vulnerabël dhe nevojave emergjente.
- dhuroi mjete shkollore për fëmijët e Fshatrave SOS Shqipëri, duke mbështetur aksesin e barabartë në edukim dhe arsimim gjatë fillimit të vitit shkollor.
- mori pjesë në “Alumni Network Meeting” të Fondacionit Tempus, duke promovuar mundësitë e karrierës dhe zhvillimin profesional për të rinjtë dhe diplomuarit shqiptarë.
- mbështeti ekspozitën fotografike “Aromë Hungarie” nga Roland Tasho në Vlorë dhe Korçë, duke promovuar dokumentimin artistik të arkitekturës dhe lidhjet kulturore midis Shqipërisë dhe Hungarisë.
- dhuroi materiale, mobilje dhe pajisje utilitare, për Bashkinë Librazhd, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe funksionimit të përditshëm.

## **BANKA PROCREDIT SHQIPËRI**


- iu bashkua aktivitetit rajonal “Women Entrepreneurs Finance Code” në Mal të Zi, në bashkëpunim me EBRD, Frankfurt School of Finance & Management dhe partnerë rajonalë, duke mbështetur dhe fuqizuar gratë në biznes.
- u angazhua në Ditën Kombëtare të Aktivizmit, e organizuar nga CoPlan, duke kontribuar si anëtar i jurisë në vlerësimin e nismave për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- mori pjesë në Javën Kulturore Gjermane 2025 në Vlorë, duke mbështetur koncertin e jazz-it në teatrin “Petro Marko” dhe promovuar artin dhe bashkëpunimin kulturor.
- u vlerësua me çmimin “Rising Star Partner” në 10-vjetorin e ADGF, duke njohur bashkëpunimin dhe ndikimin e përbashkët në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë.





## **BANKA RAIFFEISEN SHQIPËRI**

- dhuroi 250 pako ushqimore për familjet në nevojë në Njësinë Bashkiake nr. 2, Tiranë, në kuadër të nismës “Kujdesemi me zemër”.
- organizoi projektin “Heroes for Heroes” në pavionet pediatrike të QSUT, duke sjellë ngrohtësi, festë dhe dhurata për fëmijët e shtruar gjatë fundvitit.
- mbështeti premierën e operës “Il Trovatore” në TKOBAP, duke sjellë një përjetim të veçantë artistik për publikun me rikthimin e tenorit Josif Gjipali dhe interpretimin e Enkeleida Shkozës.
- krijoi dy kënde të reja lojërash për fëmijët në Konispol dhe Delvinë, në bashkëpunim me bashkitë përkatëse, duke ofruar hapësira më të sigurta për komunitetin.
- organizoi takimin “Mami dhe Unë” për nënat në leje lindjeje dhe fëmijët e tyre, duke krijuar një hapësirë mbështetëse që promovon balancën mes jetës personale dhe punës.
- u bashkua si partner në nismën “No Farms, No Food”, duke sjellë së bashku fermerë, tregtarë dhe ekspertë për të forcuar lidhjet urbane-rurale dhe duke prezantuar produkte të përshtatura për sektorin agro-biznes.
- krijoi 9 klasa burimore të pajisura për fëmijët me aftësi të kufizuara në Elbasan, Burrel dhe Gjirokastrë, dhe trajnoi 20 mësues asistentë e staf psikosocial, në partneritet me Stepic CEE Charity dhe Save the Children.
- mbështeti KoKoFest 12, Festivalin Ndërkombëtar të Komedisë në Korçë, duke sjellë 7 shfaqje teatrore nga Shqipëria, Kosova dhe Italia.
- kontribuoi në projektin “Let’s talk about sustainable finance” në Shkodër, duke ofruar aktivitete edukative për të rinjtë mbi financën e qëndrueshme dhe ESG, si dhe duke zhvilluar manuale trajnimi dhe grupe studentore me ide konkrete për të ardhmen.
- mbështeti Tirana Art Weekend 2025, një event katër-ditor që transformoi Tiranën në një rrjet arti dhe krijimtarie, me 77 artistë, mbi 15 hapësira kulturore dhe më shumë se 4,300 vizitorë.
- kontribuoi në festat e fundvitit në Sarandë, Korçë, Maliq dhe Gjirokastrë, duke ofruar dekorime dhe aktivitete që rriten gjallërinë për komunitetin.






## TIRANA BANK

- mbështeti Spitalin Onkologjik të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë përmes Fondacionit Mane, duke siguruar 30 karrige të reja për kimioterapi dhe përmirësuar ambientet e terapisë, për të ofruar kushte më dinjitoze për rreth 100 pacientë në ditë.

## BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË (UBA)

- mbështeti ekspozitën “Gratë e Tiranës”, të organizuar nga Qendra për Hapje dhe Dialog (COD) në kuadër të 16 Ditëve për Ndërgjegjësimin e Dhunës ndaj Grave, ku të ardhurat nga shitja e veprave do të shkojnë për gratë në nevojë.
- mbështeti rrugëtimin akademik të studentit Elton Korpuzi në Universitetin Albukhary të Malajzisë që nga viti 2021, duke ofruar mundësi për arsim cilësor dhe duke nxjerrë në pah shembullin frymëzues të arritjeve të tij akademike dhe sportive.
- mbështeti së bashku me Grupin Eurosig-Insig, Shtëpinë e Motrave të Nënë Terezës, përmes Fondacionit “Fëmijët Shqiptarë”, duke shpërndarë rreth 50 pako me dhurata dhe duke treguar vëmendje dhe solidaritet ndaj të moshuarve gjatë periudhës së festave të fundvitit.



1 PA VARFËRI



2 ZERO URI



3 SHëndETI I MIM DHE MIREËMË



4 ARSIM CILËSOR



5 BARAZI GJINORE



10 ZVËGËLIMI I PABARAZJVE



16 PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA



17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT





### MBËSHETJE PËR KRYQIN E KUQ SHQIPTAR:

**Banka Amerikane e Investimeve (ABI)** mbështeti Mbrëmjen Gala të Kryqit të Kuq, ku fondet e mbledhura shkuan në ndihmë të familjeve të personave me aftësi të kufizuara dhe pa përkrahje ekonomike.

**Banka Intesa Sanpaolo Shqipëri** organizoi dhurim vullnetar gjaku, për të ndihmuar fëmijët talasemikë dhe pacientët në nevojë.


**Banka OTP Shqipëri** kontribuoi financiarisht në Mbrëmjen Gala të Kryqit të Kuq, duke blerë një pikturë të realizuar nga vullnetarët, për të mbështetur shtresat në nevojë.

**Tirana Bank** kontribuoi në ankandin e pikturave në mbrëmjen e bamirësisë, duke ndihmuar përmirësimin e jetës së të moshuarve në nevojë.



### MARATONA E TIRANËS 2025:

**Banka Amerikane e Investimeve (ABI), Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Fibank Albania, Banka Intesa Sanpaolo Shqipëri, Banka OTP Shqipëri, Banka ProCredit Shqipëri, Banka Raiffeisen Shqipëri dhe Union Bank** morën pjesë duke angazhuar stafin dhe komunitetin në një aktivitet sportiv me karakter human dhe social. Pjesëmarrja e tyre promovoi shëndetin dhe aktivitetin fizik, frymën e bashkëpunimit midis kolegëve dhe vlerat e solidaritetit. Bankat mbështetën kauza sociale dhe iniciativa për mirëqenien e fëmijëve dhe komunitetit, duke e kthyer pjesëmarrjen në një shprehje të angazhimit të tyre për jetesën e shëndetshme dhe përgjegjësinë sociale.



### TETORI ROZË - PËR PARANDALIMIN E KANCERIT TË GJIRIT:

**Banka Amerikane e Investimeve (ABI)** mbështeti librin "Një ditë tjetër" të gazetares Mira Kazhani, duke sjellë një mesazh shprese dhe reflektimi për jetën.

**Banka Intesa Sanpaolo Shqipëri** vendosi një baner me fjalon rozë në degën qendrore për të nxitur kontrolle të rregullta dhe kujdes për shëndetin e grave.

**Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA)** ofroi një paketë të dedikuar 50 euro, duke përfshirë ekzaminime dhe analiza të nevojshme për gratë dhe vajzat, me qëllim ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e shëndetit.



1 PA VARFËRI



2 ZERO URI



3 SHËNDETTI IM DHE MIRËQENI



4 ARSIM GJËSOR



5 BARAZI GJINORE



10 ZVOGËLIMI I PABARAZYVE



16 PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA



17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

# **PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE**

Broshurë 3-mujori i katërt  
Tetor - Dhjetor 2025

[www.aab.al](http://www.aab.al)